



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 435/ 2 prot.,

Datë 01.03.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Silver*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-55558-12-30-2022, me objekt “*Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*”, me fond limit 17,507,638 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Silver*” SHPK
Adresa: Rruga “Bajram Curri”, Pall. 1 Maj, God 7, Shk 4, Kt. 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv ”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK
Adresa: Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pall. 2, Shk. 10, Ap. 76, Tiranë.

Në datën 28.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 435 prot, datë 28.02.2023 e operatorit ekonomik “*Silver*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-55558-12-30-2022, me objekt “*Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*”, me fond limit 17,507,638 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Silver” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Silver” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 435 prot., datë 28.02.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

Në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2 seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, sipas Shenimit 2.1, “Ne cdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi fitues duhet që të dorëzojë dokumentacionin provues sipas profilit të cdo punonjesi pranë AK.” Pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë në formë të shkruar nga ofertuesi “SILVER” SH.P.K. me shkresën nr. 18 prot. Date 13.02.2023, protokolluar me tonen nr. 259 date 13.02.2023 rezultoi se, Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me profilet e detyrueshme të stafit kryesor, dhe konkretisht për funksionin “Përgjegjës me profil inxhinier mjedisi”. Ofertuesi ka deklaruar në tabelën e stafit, punonjesin I. K. me profesion Inxhinier Mjedis, të cilin e ka saktësuar me kthimin e përgjigjes për sqarim nr. 17 date 08.02.2023, në rolin e “Përgjegjës”. Nderkohe që, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar, nuk rezultoi që ky punonjes të ketë diplome për “Inxhinier mjedisi”, sic ka deklaruar ofertuesi në SPE në ditën e hapjes së ofertave dhe sic kërkohet në pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, por ka diplome në “Inxhinier i Agromjedisit”. Bazuar në paragrafin e fundit të Shtojcës 8 të DST, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.03.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri